

 <b>QENDRA PËR SHËRBIM TË OYTETARËVË</b> <b>CENTAR ZA USLUGU GRADANA</b>	<b>Sh. Nr. 10998</b> <b>U. 02 Br. 08/04</b> <b>Nr. i faq. 9 Data: 08/04</b> <b>Br. str. KAMENICË/A Datum: 2024</b>	
<b>Republika e Kosovës</b> <b>Republika e Kosova</b> <b>Republic of Kosovo</b>	<b>Komuna e Kamenicës</b> <b>Opština Kamenica</b> <b>Kamenica Municipality</b>	

## KONTRATË

Numri i kontratës<sup>1</sup>: KM653-24-1529-2-2-1/C541

**KOMUNA E KAMENICËS** (në vazhdim "Autoriteti Kontraktues"), në njëren anë; dhe

**Idriz Shala, Rr. Hilmi Rakovica, Prishtine, 1010682114**, (ne vazhdim "Ofruesi i Shërbimeve"), ne anën tjetër, janë pajtuar te lidhin një kontrate publike për shërbimet e shënuara me poshtë:

Shërbime të Konsulencës me numër identifikues: KM653-24-1529-2-2-1

### Neni 1 Lënda

1.1 Lënda e kontratës është performimi i shërbimeve në vijim nga ana e Ofruesit te Shërbimeve:

Sipas D.T

No.	Lot
3	Lot3 Shërbimet e Konsulencës –Konsulent – Ekspert i GIS

### Neni 2 Çmimi

2.1 Çmimi total i shërbimeve duhet të jetë: **8,808.00 €**; TetëmijëzetëqindetëEuro.

2.2 Çmimi i përmendur në Nenin 2.1 më sipër duhet të jetë e vetmja pagesë që Autoriteti Kontraktues i ka borxh Ofruesit te Shërbimeve sipas kontratës. Ai duhet të jetë i prerë dhe të mos i nënshtronet ndryshimeve.

2.3 Pagesat do të bëhen në pajtum me Kushtet e përgjithshme dhe/ose të Veçanta të kontratës.

### Neni 3 Rendi i përparrësisë i dokumenteve të kontratës

3.1 Kontrata përbëhet nga dokumentet në vijim:

- (a) Kjo Marrëveshje e Kontratës;
- (b) Kushtet e Veçanta të Kontratës;
- (c) Kushtet e Përgjithshme të Kontratës;
- (d) Tenderi i Konsulentit, (Propozimin Teknik dhe Financiarë).

3.2 Dokumentet e ndryshme që e përbëjnë kontratën konsiderohet se shpjegojnë njëra tjetrën; dhe në raste të paqartësisë ose divergjencës, ato duhet të lexohen sipas rendit të përparrësisë në të cilin janë dhënë më sipër.

### Neni 4 Komunikimet

4.1 Të gjitha komunikimet me shkrim që kanë të bëjnë me këtë Kontratë ndërmjet Autoritetit Kontraktues, nga njëra anë dhe Konsulenti nga ana tjetër duhet të cekin titullin e Kontratës dhe numrin e saj të identifikimit dhe duhet të dërgohen me postë, faks, email ose të dorëzohen personalisht.

4.2 Nëse personi që dërgon komunikatën kërkon vërtetim të pranimit të saj, ai duhet ta ihotë këtë në komunikatën e tij. Sa herë që ka afat të fundit për pranimin e komunikatës me shkrim, dërguesi duhet

<sup>1</sup>Ju lutemi referojuni këtij numri të kontratës në dokumentet e faturimit dhe pagesës, procedurat dhe transaksionet që lidhen me thesin.

të kërkojë vërtetim të pranimit të komunikatës së tij. Në të gjitha rastet, dërguesi duhet t'i marrë të gjitha masat e nevojshme për të siguruar pranimin e komunikimit të tij.


4.3 Kudo në kontratë parashikohet për dhënien e ndonjë njoftimi, pëlqimi, miratimi, certifikate, ose vendimi, përveç nëse specifikohet ndryshe në njoftim të tillë, pëlqim, miratim, certifikatë apo vendim do të jetë në formë të shkruar dhe fjalët "njofton", "vërtetojë", "miratoj" "ose" vendosë "do të interpretohen në përputhje me rethanat. Ndonjë miratim, pajtim, certifikatë ose vendim i tillë nuk duhet të mbahet apo vonohet pa arsy.

4.4 Kjo kontratë është e përgatitur në gjuhën Shqipe në tri origjinale, dy prej të cilave janë për Autoritetin Kontraktues dhe një origjinale për Konsulentin.

#### Për Autoritetin Kontraktues

Emri:	Urim Thaqi
Pozita:	Zyrtar përgjegjës i prokurimit
Nënshkrimi:	
Data:	08.04.2024
Vula:	

#### Për Ofruesin e Shërbimeve

Emri:	Idriz Shala
Pozita:	Konsulent
Nënshkrimi:	
Data:	08.04.2024
Vula:	

## **SEKSIONI II I KONTRATES**

## **KUSHTET E PËRGJITHSHME**

### **Neni 1 Përkufizimet**

1.1 "Kontratë" do të thotë marrëveshje të lidhur ndërmjet Autoritetit kontraktues dhe Konsulentit, siç është shënuar në formularin e kontratës të nënshkruar nga palët, duke përfshirë të gjitha shtojcat për këtë dhe të gjitha dokumentet e inkorporuar me referencë në të.

1.2 "Shërbimet" do të thotë shërbimet qe do te ekzekutohen nga ana e Konsulentit siç është përshkruar në TER.

1.3 "Konsulenti" është personi fizik, i caktuar në formularin e kontratës, që është palë në kontratë dhe i detyruar të kryej detyrat në bazë të marrëveshjes, dhe që për detyrat e kryera do të marrë shumën e rënë dakord në formularin e kontratës.

1.4 "Çmimi i kontratës" do të thotë shuma e deklaruar në Marrëveshjen që përfaqëson shumën totale të pagueshme për ofrimin e Shërbimeve.

### **Neni 2 Ligji i aplikueshëm dhe gjuha**

2.1 KVK e saktësojnë cili është ligji që i përcakton të gjitha çështjet që nuk janë të mbuluara në kontratë.

2.2 Kontrata dhe të gjitha komunikimet e shkruara ndërmjet palëve hartohen në gjuhën e specifikuar në KVK.

### **Neni 3 Transferimi**

3.1 Ne asnjë rrethane nuk lejohet transferimi.

### **Neni 4 Nën-kontraktimi**

4.1 Me përjashtim të funksioneve të ndihmës administrative, Konsulentit nuk i lejohet të nënkontraktojë asnjë nga përgjegjësítë e tij.

### **Neni 5 Tatimet dhe Doganat**

5.1 Konsulenti është përgjegjës për të gjitha taksat dhe doganat në pajtim me Ligjin e Republikës së Kosovës.

### **Neni 6 Fillimi dhe Përfundimi i shërbimeve**

6.1 Kjo kontratë hyn në fuqi në datën e nënshkrimit të kontratës nga të dy palët ose ne një date tjeter të mëvonshme siç mund të ceket në KVK.

6.2 Konsulenti do të fillojë shërbimet në datën e specifikuar në KVK, që do të përkufizohet si "Data Efektive".

6.3 Përveç nëse ndërpritet më herët sipas Nenit 9 dhe 10, kjo Kontratë do të skadojë në fund të periudhës së tillë kohore pas Datës Efektive të specifikuar në KVK.

6.4 Vendi i kryerjes së shërbimeve është i përcaktuar në KVK.

### **Neni 7 Forca madhore**

7.1. Termi "forcë madhore" do të thotë veprimet e zotit, goditjet, mylljet e objektit ose çrrregullimet tjera industriale, veprimet e armikut publik, luftërat qofshin të deklaruara ose jo, bllokadat, rebelimet, rastet e dhunës, epidemitë, rrëshqitjet e tokës, tërmetet, shtrëngatat, vetëtima, vërvshimet, erozionet, trazirat civile, eksplodimet dhe ndonjë ngjarje tjeter e ngjashme e paparashikuar që është përtëj kontrollit të palëve dhe nuk mund të përballohet as me kujdesin e duhur.

7.2. Asnjëra palë nuk konsiderohet se ka bërë shkelje të obligimeve të saj sipas kontratës nëse realizimi i obligimeve të tillë parandalohet nga ndonjë ngjarje e shkaktuar nga një forcë *madhore* që shkaktohet pas datës së njoffimit mbi dhënie të kontratës ose kur kontrata hyn në fuqi, me kusht që Pala e ndikuar nga raste të tillë ka marrë parasysh të gjitha evitimet dhe kujdesin e mundshëm si dhe masat e mundshme alternative, të gjitha me qëllim të performimit të kushteve dhe termeve të kontratës.

7.3. Pala e ndikuar nga një ngjarje e forcës madhore do të marrë të gjitha masat e arsyeshme për të mënjanuar paaftësinë e një pale të tillë që të përmbush detyrimet e saj tanë e tutje me një vonesë minimale.

7.4. Një palë e afektuar nga një Forcë Madhore do të njoffoi Palén tjetër për një ngjarje të tillë sa më shpejt të jetë e mundshme, dhe në çdo rastë jo më vonë se katërmëdhjetë (14) ditë pas ndodhjes së një rasti të tillë, duke ofruar evidencë të natyrës dhe shkaktarëve të ngjarjes së tillë, dhe ngjashëm do të njoffoi me shkrim pas restorimit të kushteve normale sa më shpejtë të jetë e mundshme.

7.5 Çdo periudhë kohore që nuk realizohen shërbimet si rezultat e ngjarjeve të Forcave Madhore, përfundimi i ndonjë aktiviteti apo detyre, do të zgjasë periudhën për aq kohë sa ka ekzistuar gjendja e Forcës Madhore që ka pamundësuar Palës realizimin e aktiviteteve.

7.6 Gjatë periudhës së pamundësisë për performimi e shërbimeve si rezultat e ngjarjeve të Forcave Madhore, Konsulenti, me udhëzim të Autoritetit Kontraktues, do të:

(i) demobilizohet, në ç'rast Konsulenti do të reimbursohet pér kosto shtesë të cilat i kanë shkaktuar arsyeshëm, dhe, nëse kërkohet nga Autoriteti Kontraktues, pér riaktivizimin e Shërbimeve; ose

(ii) do të vazhdoi me shërbime pér aq sa është e mundshme, në të cilin rast Konsulenti do të vazhdoi të paguhet nën kushtet e kësaj kontrate dhe të kompensohet pér kosto shtesë të shkaktuara arsyeshëm.

7.7 Në rastë të mospajtimit në mesë të Palëve pér ekzistencën apo rëndësinë e Forcës Madhore, çështja do të zgjidhet sipas Nenit 19.

#### Neni 8 Pezullimi

8.1 Autoriteti Kontraktues, me njoftim me shkrim të pezullimit të Konsulentit, mund të suspendoi të gjitha pagesat pér Konsulentin nëse Konsulenti dështon të kryej ndonjë nga obligimet e tij/saj nën këtë kontratë, përfshirë performimin e shërbimeve, me kusht që njoftimi i tillë pér pezullim (i) do të specifikojë natyrën e dështimit, dhe (ii) do të kërkojë konsulentit që të përmirësojë një dështim të tillë brenda periudhës jo më shumë se tridhjetë (30) ditë pas pranimit të njoftimit të tillë pér pezullim nga Konsulenti.

#### Neni 9 Ndërprerja e Kontratës nga Autoriteti kontraktues

9.1 Autoriteti kontraktues mundet që, pasi t'i japë Konsulentit shtatë ditë paralajmërim, ta ndërpresë kontratën në ndonjërin nga rastet e mëposhtme:

(a) Konsulenti dështon në përmbushjen brenda një ariati të arsyeshëm të paralajmërimit të dhënë nga autoriteti kontraktues që kërkon nga ai të evitojë ndonjë neglizhencë apo dështim pér të realizuar obligimet e veta sipas kontratës, dhe të cilat ndikojnë në mënyrë serioze në realizimin e duhur dhe me kohë të shërbimeve;

(b) Konsulenti refuzon ose është neglizhent në realizimin e urdhreve administrative të dhëna nga autoriteti kontraktues;

(c) Konsulenti ia jep dikujt kontratën;

(d) Konsulenti është dënuar pér një shkelje që ka të bëjë me sjelljen profesionale, përmes një gjykimi që ka fuqinë e *res judicata*;

(e) Konsulenti është shpallur fajtor pér sjellje të rëndë të keqe jo profesionale të dëshmuar me çfarëdo mjeti të cilin mund ta vërtetoj Autoriteti kontraktues;

(f) Konsulenti i është nënshtruar një gjykimi që ka forcën e *res judicata* pér mashtrim, korruption, përfshirje në ndonjë organizatë kriminale;

(g) Si rezultat i Forcës Madhore, Konsulenti nuk është në gjendje që të kryej pjesë kryesore të Shërbimit pér një periudhë jo më pak se gjashtëdhjetë (60) ditë;

(h) Autoriteti Kontraktues, me vendim të tij dhe pér çfarëdo arsy, vendosë të ndërperej kontratën.

#### Neni 10 Ndërprerja e Kontratës nga ana e Konsulentit

10.1 Konsulenti, pasi e ka paralajmëruar me shkrim Autoritetin kontraktues 30 ditë paraprakisht, mund ta ndërpresë kontratën nëse Autoriteti kontraktues:

a. nuk arrin t'i paguajë Konsulentit shumat që duhet të paguhen në ndonjë certifikatë të lëshuar nga personi i autorizuar pas skadimit të afatit të fundit;

b. ose, si rezultat i Forcës Madhore, Konsulenti është i paafëtë të kryej një pjesë materiale të Shërbimeve pér një periudhë prej jo më pak se gjashtëdhjetë (60) ditë.

#### Neni 11 Ndërprerja e të drejtave dhe obligimeve me ndërprerje të kontratës

11.1 Me ndërprerje të kontratës sipas Nenit 6.5, Nenit 9 dhe 10, ose me skadimin e kësaj kontrate sipas Nenit 6.3, të gjitha të drejtat dhe obligimet e Palëve do të ndërkrenhen, përvèç (i) të drejta të tillë dhe obligime që mund të jenë akumuluar në ditën e ndërprerjes apo skadimit, (ii) obligimi i konfidencialitetit i parashtruar në Nenin 13.6 (iii) oblimi i Konsulentit pér të lejuar inspektimin, kopjimin dhe auditivin e llogarive të tyre apo të dhënave të caktuara në Nenin 13.8 dhe 13.9, dhe (iv) çdo e drejtë të cilën një Palë mudn të ketë nën Ligjin e Aplikueshëm.

11.2 Me ndërprerje të kontratës me njoftim të cilësdo palë ndaj tjetrës sipas nenit 9 dhe nenit 10, Konsulenti duhet, menjëherë pas dërgimit të njoftimit të tillë, të merr të gjitha hapat e nevojshme pér të sjellur shërbimet deri në përmbyllje në mënyrë të shpejtë dhe duhet të bëjë atë që është e mundur pér të mbajtur shpenzimet pér këtë qëllim në minimum. Në lidhje me dokumentet e përgatitur nga Konsulenti dhe pajisjet dhe materialet e furnizuara nga Autoriteti Kontraktues, Konsulenti do të vazhdojë siq është paraparë, respektivisht, me Nenin 13.12.

#### Neni 12 Pagesa pas Ndërprerjes

12.1 Me ndërprerje të kësaj kontrate sipas Nenit 9 dhe 10, Autoriteti Kontraktues do të bëjë pagesat në vijim për Konsulentin:

- Pagesa sipas nenit 16 për shërbimet e kryera me sukses para datës efektive të ndërprerjes; dhe
- Përveç në raste të ndërprerjes sipas paragrafit (a) deri në (i) të Nenit 9, kompensimi i çdo kostoje të arsyeshme deri në ndërprerjen e kësaj Kontrate.

#### Neni 13 Obligimet e Konsulentit

13.1 Konsulenti do të kryejë Shërbimet dhe kryejnë detyrimet e tyre, me gjithë kujdesin e duhur, efikasitetit dhe ekonomisë, në përputhje me standartet dhe praktikave të pranuara përgjithësisht profesionale, dhe do të respektojë praktikat e menaxhimit të shëndoshë, dhe të përdorin teknologji të përshtatshme dhe pajisjet, makineri, materialt dhe metodat e sigurta dhe efektive. Konsulenti duhet të veprojë gjithmonë, në lidhje me çdo çështje në lidhje me këtë Kontratë ose për shërbimet, si këshilltar besnik ndaj Autoriteti Kontraktues, dhe do të në çdo kohë duke mbështetur dhe mbrojtur interesat e ligjshme të Autoritetit Kontraktues.

13.2 Konsulenti duhet të respektojnë dhe të respektoj të gjitha ligjet dhe rregulloret në fuqi në Republikën e Kosovës.

13.3 Konsulenti do të vendos interesat e Autoritetit Kontraktues si prioritet, pa ndonjë konsideratë për punën e ardhshme, dhe në mënyrë rigorozë duke shmangur konfliktet me detyra të tjera ose interesat e tyre korporative.

13.4 Konsulenti pajlohet që, gjatë afatit të kësaj Kontrate dhe pas përfundimit të saj, Konsulenti dhe çdo subjekt lidhur me konsulentin, do të diskualifikohet nga furnizimi i mallrave, punime ose shërbime (me përjashtim të shërbimeve të konsulencës), që rrjedhin nga ose janë të lidhur direkt me Shërbimet.

13.5 Konsulenti nuk do të angazhohet, qoftë direkt ose indirekt, në aktivitetet e çdo biznesi apo aktivitete profesionale që do të bien ndesh me aktivitetet e caktuar sipas kësaj Kontrate.

13.6 Me përjashtim me pëlqimin paraprak me shkrim të autoritetit kontraktues, Konsulenti nuk do të komunikojnë në asnjë kohë për asnjë person apo subjekt asnjë informacion konfidencial fituar në rrjedhën e Shërbimeve, po ashtu Konsulenti nuk do të bëjë publike rekomandime të formuluara gjatë, apo si rezultat i Shërbimeve.

13.7 Konsulenti duhet të mbajë, llogaritë të sakta dhe sistematike dhe të dhënat në lidhje me kontratën, në përputhje me parimet e kontabilitetit të pranuara ndërkombëtarisht dhe në atë formë dhe detaje që do të identifikojë qartë ndryshimet përkatëse të kohës dhe kostos.

13.8 Konsulenti do të lejojë, autoriteti kontraktues për të inspektuar të gjitha llogaritë dhe të dhënat lidhur me zbatimin e kontratës dhe dorëzimit të propozimit për të ofruar shërbime, dhe të ketë llogaritë dhe regjistrat auditohen nga auditorë.

13.19 Konsulenti do t'i dorëzojë Autoriteti Kontraktues raportet dhe dokumentet e specifikuara brenda afateve të përcaktuara në shtojcën e përmendur. Raportet përfundimtare do t'i dorëzohet në CD-ROM.

13.10 Të gjitha planet, vizatimet, specifikimet, projektilimet, raportet, dokumentet tjera dhe softvere të përgatitura nga Konsulenti për autoritetin kontraktues në bazë të kësaj kontrate do të bëhen dhe mbeten pronë e autoritetit kontraktues, dhe Konsulenti duhet, jo më vonë se pas përfundimit apo skadimit të kësaj Kontrate, të dorëzojë të gjitha dokumentet e tillë për autoritetin kontraktues, së bashku me një inventar të detajuar të tij. Konsulenti mund të mbajë një kopje të dokumenteve të tillë dhe softver, dhe të përdorin softuer të tillë për përdorimin e tyre me miratimin paraprak me shkrim të autoritetit kontraktues. Në qoftë se marrëveshjet e licencës janë të nevojshme ose të përshtatshme në mes Konsulentit dhe palëve të treta për qellime të zhvillimit të çdo programeve kompjuterike të tillë, Konsulenti duhet të marrë miratimin paraprak me shkrim të autoritetit kontraktues për marrëveshje të tillë, dhe Autoriteti kontraktues ka të drejtë në diskrecionin e saj të kërkojë shpenzimet e lidhura me zhvillimin e programit (eve) përkatës. Kufizime të tjera për përdorim në të ardhmen e këtyre dokumenteve dhe softvereve, nëse ka, do të specifikohen në KVK.

#### Neni 14 Obligimet e Autoritetit Kontraktues

14.1 Përveç nëse specifikohet në ndryshe në KVK, Autoriteti Kontraktues do të siguron Konsulentin, me leje të punës dhe dokumentet tjera të tillë që do të janë të nevojshme për të mundësuar, Konsulentin për kryerjen e Shërbimeve.

14.2 Nëse pas datës së kësaj Kontrate, nuk ka ndonjë ndryshim në ligjin në fuqi në lidhje me taksat dhe detyrimet e cila rrit ose ul koston e shkaktuar nga Konsulenti në kryerjen e shërbimeve, pagesat për Konsulentin sipas kësaj kontrate nuk do të ndryshohen.

14.3 Në konsideratë të shërbimeve të kryera nga Konsulenti nën këtë kontratë, Autoriteti Kontraktues do të bëjë pagesat e Konsulentit të tilla dhe në atë mënyrë që është parashikuar në nenin 16 të kësaj kontrate.

14.4 Autoriteti Kontraktues do të vejë në dispozicion të Konsulentit pa pagesë personel të tillë professional dhe homolog mbështetje, që do të emërohen nga Autoriteti Kontraktues me këshilla të Konsulentit

#### Neni 15 Pagesa për Konsulentin

15.1 Pagesa totale që duhet paguar Konsulentin nuk duhet të tejkalojë çmimin e Kontratës.

15.2 Çmimi total i kontratës është vendosur në KVK.

15.3 Pagesat do të bëhen në euro. Pagesat e Konsulentit do të bëhen sipas orarit të pagesës të përcaktuara në KVK dhe ndaj një fature. Përveç nëse është përcaktuar ndryshe në KVK, pagesa e parë do të bëhet ndaj dispozitiveve nga Konsulentët të një garancie bankare për të njëjtën shumë, dhe do të jetë e vlefshme për periudhën e përcaktuari në KVK. Çdo pagesë tjetër do të bëhet pasi që kushtet e dhëna në KVK për pagesë të tillë janë plotësuar, dhe Konsulentët kanë paraqitur një faturë original dhe çdo informacion shtesë dokumentuese për Autoritetin Kontraktues që cakton shumën e duhur

15.4 Pagesat që duhet te bëhen sipas faturës se lëshuar nga Konsulenti do të bëhen në llogarinë bankare të dhënë në Pjesën V, Identifikimi Financiar, i kësaj kontrate që e plotëson Ofruesi i Shërbimeve. I njëjti formular, që i bashkëngjitet kërkesës për pagesë, duhet të përdoret për t'i raportuar ndryshimet në llogarinë bankare.

15.5 Shumat duhet të paguhen brenda jo më shumë se 30 ditësh kalendare nga data në të cilën kërkesa e pranueshme për pagesë është regjistruar nga departamenti përkatës. Data e pagesës do të jetë data në të cilën debitohet llogaria e institucionit. Kërkesa për pagesë nuk do të jetë e pranueshme nëse nuk plotësohen një ose më shumë nga kërkesat thelbësore.

15.6 Periudha prej 30-ditësh mund të pezullohet duke e lajmëruar Konsulentin që kërkesa për pagesë nuk mund të plotësohet sepse shuma nuk do të paguhet për shkak se nuk janë dorëzuar dokumentet e duhura përbmajtjesore ose sepse ka dëshmi që shpenzimi mund të mos jetë legjitim. Në rastin e fundit mund të bëhet një inspektim i merjëhershëm për qëllim të kontrollimeve tjera. Konsulenti do të japë sqarime, modifikime apo informata të tjera brenda 15 ditësh pas kërkesës. Periudha e pagesës do të llogaritet nga data në të cilën është regjistruar kërkesa për pagesë e përgatitur në mënyrën e duhur.

15.7 Pasi që të ketë kaluar afati i fundit i dhënë në Nenin 16.5, Konsulenti mundet që, brenda dy muajsh pas pagesës së vonuar, të kërkojë interesin për pagesë të vonuar me normë të re-zbritje që zbatohet nga Banka Qendrore e Kosovës në ditën e parë të muajit në të cilin ka skaduar afati i fundit, plus shtatë pikë të përqindjes. Interesi për pagesë të vonuar do të zbatohet për kohën që kalon ndërmjet datës së afatit të fundit të pagesës (nuk përfshihet) dhe datës në të cilën debitohet llogaria e Autoritetit kontraktues (përfshihet).

15.8 Të gjitha mos pagesat pas 90 ditësh nga skadimi i periudhës së dhënë në Nenin 16.3 do t'i jasin të drejtë Konsulentit që ose të mos e realizojë kontratën, ose ta ndërpresë atë, me paralajmërim prej 30 ditësh për Autoritetin kontraktues.

#### Neni 16 Zgjidhja miqësore e mosmarrëveshjeve

16.1 Palët duhet t'i bëjnë të gjitha përpjekë për të zgjidhur në mënyrë miqësore të gjitha mosmarrëveshjet që mund të ndodhin ndërmjet tyre. Sapo të shfaqet ndonjë mosmarrëveshje, palët do ta lajmërojnë njëra tjetrën me shkrim për qëndrimet e tyre në mosmarrëveshje dhe për ndonjë zgjidhje që ata konsiderojnë se është e mundshme. Nëse cilado palë e sheh të dobishme, palët do të takohen dhe të mundohen ta zgjidhin mosmarrëveshjen. Pala do të i përgjigjet kërkesës për zgjidhje miqësore brenda 15 ditësh pas kërkesës.

Periudha maksimale që jepet për arritjen e kësaj zgjidhjeje do të jetë 30 ditë nga fillimi i procedurës. Nëse përpjekja për të arritur zgjidhje miqësore dështon ose nëse pala dështon të përgjigjet me kohë ndaj kërkesave për zgjidhje, të dyja palët do të jenë të lira të vazhdojnë në fazën e ardhshme të procedurës së zgjidhjes së mosmarrëveshjes duke e lajmëruar tjetrën.

16.2 Nëse procedura e zgjidhjes miqësore të mosmarrëveshjes dështon, palët mund të merren vesh të përpiqen të pajtohen përmes institucion të specifikuar në KVK. Nëse nuk mund të arrihet zgjidhja brenda 30 ditësh pas fillimit të procedurës së pajtimit, secila palë do të ketë të drejtë të vazhdojë në fazën e ardhshme të procedurës së zgjidhjes së mosmarrëveshjes.

#### **Neni 17      Zgjidhja e mosmarrëveshjeve me procedurë gjyqësore**

17.1 Nëse nuk mund të arrihet zgjidhje brenda 30 ditësh nga fillimi i procedurës miqësore për zgjidhje të mosmarrëveshjes, secila palë mund të kërkojë:

- a)vendim nga gjyqi; ose
- b)kur palët pajtohen, një vendim arbitrimi në pajtim me KVK.

17.2 Modeli i zgjidhjes së mosmarrëveshjeve p.sh. gjykata ose arbitrazhi do të vendoset nga palët para nënshkrimit të kontratës

#### **Neni 18      Dëmshpërbllimi**

18.1 Konsulenti do të mbrojë dhe dëmshpërbujej Autoritetin Kontraktues dhe zyrtarët e saj actual dhe ish-drejtoret, punonjësit, dhe agjentët dhe të ruaj ata nga démet dhe kundër çdo kosto, humbjet, dëmtimet, dhe jobat e shkaktuara nga Autoriteti Kontraktues, duke përfshirë por jo kufizuar në tarifat e avokatëve dhe shpenzimet në lidhje me ndonjë: neglizhencë ose keqpërdorime të qëllimshme nga ana e ofruesit të shërbimeve, shkelje ose shkelje të pretenduar të përfaqësive të Konsulentit, ankesë nga një palë e tretë që ofrimin e këtyre shërbimeve nga Konsulenti ose shfrytëzim nga apo në emër të Autoritetit Kontraktues ose të aseteve të përdorura ose të siguruar nga Konsulenti në lidhje me kryerjen e shërbimeve shkel të drejtat e pronësisë intelektuale të asaj pale të tretë.

### SEKSIONI III I KONTRATES

### KUSHTET E VEÇANTA

KVK në vijim do të plotësojnë dhe/ose ndryshojnë KPK. Sa herë që ka një konflikt, dispozitat këtu do të mbizotërojnë mbi ato të KPK.

Kushtet e Përgjithshme të Kontratës		Amandamentimet/Modifikimi i Nenit përkatës në KPK
Përshkrimi i nenit	Nr. Nenit	
Ligji i zbatueshëm dhe gjuha	2.1	Ligjet e Kosovës që janë në fuqi do të zbatohen për të gjitha çështjet që nuk mbulohen nga dispozitat e kontratës. Juridiksoni do të jetë gjykata përkatëse në Prishtinë.
	2.2	Gjuha e përdorur do të jetë shqipe.
Fillimi dhe Përfundimi i shërbimeve	6.1	<i>Kontrate hyn ne fuqi me date 08.04.2024 dhe perdndon me date 07.04.2025</i>
	6.2	Data e Fillimit të fillimit të Shërbimeve 08.04.2024
	6.3	Data e Skadimit të Kontratës është 07.04.2025
	6.4	Vendi i kryerjes së shërbimeve është <b>Komuna e Kamenicës-Drejtoria e Urbanizmit</b>
Obligimet e Konsulentit	13.10 (c)	<i>Të parapara ne Termat e References</i>
Obligimet e Autoritetit Kontraktues	14.1	<i>AK do t'i asistojë Konsulentit me të gjitha dokumentacionet dhe shënimet si dhe dokumentacionin tjetër të nevojshëm për përshkrimin e detyrave ne TeR.</i>
Pagesat për Konsulentin	15.2	Çmimi total i kontratës është <b>8,808.00</b>
Pagesa	15.3	<i>Pagesa do te behet çdo muaj pas vertetimit te pageses nga menaxheri i Kontrates</i>
Zgjidhja miqësore e mosmarrëveshjes	16.2	<i>Konsulenti dhe A.K</i>
Zgjidhja e mosmarrëveshjes me procedure gjyqësore	17.1	<p>a) Çdo mosmarrëveshje ndërmjet palëve të cilat mund të lindin gjatë ekzekutimit së kësaj kontrate dhe se nuk është e mundur të zgjidhet ndryshe ndërmjet palëve do të dorëzohet Gjykatën Themelore-Prishtinë në pajtim me ligjin në Kosovë.</p> <p>b) kurdo qe palët pajtohen, çdo mosmarrëveshje ndërmjet palëve të cilat mund të lindin gjatë ekzekutimit së kësaj kontrate dhe se nuk është e mundur të zgjidhet ndryshe ndërmjet palëve do të dorëzohet në arbitrazh të Tribunali i Përhershëm i Arbitrazhit të Kosovës në kuadër të Odës Ekonomike të Kosovës, në përpunje me rregullat e Dhomës Ndërkombëtare të Tregtisë.</p> <p>Para nënshkrimit te kontratës palët duhet te vendosin për mënyrën e zgjidhjes se mosmarrëveshjes, gjykata apo arbitrimi.</p>


**Lot3 Shërbimet e Konsulencës –Konsulent – Ekspert i GIS**

1	Pershkrimi i pozicionit	Njesia	Sasia	Cmimi	Total
1.1	Lot3 Shërbimet e Konsulencës –Konsulent – Ekspert i GIS	muaj	12	734	880
					<b>880</b>
1	<b>TOTALI</b>				<b>8808</b>

Dorezuar nga:	
O.E.	Idriz Shala
Data	07.03.2024
Nenshkrimi	
Vula	